



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK
NJËSIA BAZË (DEPARTAMENTI) I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT
JAVA 07
09 shkurt – 15 shkurt 2026

Për këtë javë, kanë raportuar 36 Njësi Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) ose 100% (=36/36) e tyre.

Tabela 1. Plotësimi i formularit ALERT sipas çdo NJVKSH-je

Përqindja e plotësueshmerisë				
Rajoni	Qarku	Njvksh	Nr. Qendrave	%
TIRANË	Tiranë	Tiranë	35 / 35	100%
		Kavajë	10 / 10	100%
	Durrës	Durrës	20 / 20	100%
		Krujë	6 / 6	100%
	Dibër	Dibër	16 / 16	100%
		Mat	13 / 13	100%
		Bulqizë	9 / 9	100%
ELBASAN	Elbasan	Elbasan	27 / 27	100%
		Librazhd	11 / 11	100%
		Gramsh	8 / 8	100%
		Peqin	6 / 7	86%
	Korçë	Korçë	18 / 18	100%
		Pogradec	9 / 9	100%
		Devoll	6 / 6	100%
		Kolonjë	4 / 4	100%
	Berat	Berat	15 / 15	100%
		Kuçovë	4 / 4	100%
Skrapar		7 / 7	100%	
SHKODËR	Shkodër	Shkodër	19 / 19	100%
		M. Madhe	6 / 6	100%

		Pukë	11 / 11	100%
	Kukës	Kukës	12 / 14	86%
		Has	5 / 5	100%
		Tropojë	9 / 9	100%
		Lezhë	Lezhë	10 / 10
	Kurbin		5 / 5	100%
	Mirditë		5 / 6	83%
VLOREË	Vlorë	Vlorë	21 / 21	100%
		Sarandë	10 / 10	100%
		Delvinë	5 / 5	100%
	Fier	Fier	20 / 20	100%
		Lushnjë	18 / 18	100%
		Mallakastër	8 / 9	89%
	Gjirokastër	Gjirokastër	21 / 21	100%
		Përmet	8 / 8	100%
		Tepelenë	6 / 7	86%
			TOTAL	423 / 429

Tabela 2. Numri Total i Rasteve të Sindromave të Survejancës “Alert” në Javën 07

	JAVA 07
Diarre pa gjak	1283
Diarre me gjak	0
Inf. Resp. të sipërme	10108
Inf. Resp. të poshtme	4528
Rash me temperaturë	16
Verdhëza	0
Ethe e zgjatur e pashpjeguar (> 3 javë)	0
Anomali kongenitale	0
Konjuktivit akut te neonatët	0
Numri i Njësive Raportuese	423
% e Njësive Raportuese	99% (423/429)

Rash me temperaturë


Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog, rastet e mëposhtme nuk janë të dyshuar për fruth, rubeolë apo linë e majmunit, por për variçelë:

Tiranë – 11 raste


Fier– 2 raste

Berat– 3 raste



Grafiku 1. Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas javëve



Grafiku 2. Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas grupmoshave




Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme paraqet ulje në javën 07 të vitit 2026 krahasuar me javën paraardhëse, java 06.

Grafiku 3. Trendi në kohë i Diarreve pa gjak sipas javëve**Grafiku 4. Shpërndarja e Diarreve pa gjak sipas grup-moshave**


Prirja në kohë e “Diarreve pa gjak” paraqet ulje në javën 07 të vitit 2026 krahasuar me javën paraardhëse, java 06.

Grafiku 5. Krahasimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000




Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme paraqet ulje në javën 07 krahasuar me javën paraardhëse, duke mbetur brenda kufijve të aktivitetit sezonal normal.

Grafiku 6. Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” në javët 45 – 07 të sezonit 2024-2025 dhe sezonit 2025-2026. Numri i rasteve.




Në javën 07 të vitit 2026 vërehet një ulje e numrit të Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme.

Grafiku 7. Frekuenca e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas grupmoshës. Incidenca (raste/10.000)




Grafiku 8. Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas NJVKSH-ve në javën 06/2026 dhe 07/ 2026. Incidenca (raste/10.000).




Vërehet një ulje e infeksioneve respiratore në disa NJVKSH, në përputhje me rënien e përhapjes së gripit në vend. Aktiviteti i gripit këtë javë paraqitet në rënie, megjithatë mbetet i përhapur në të gjithë territorin e vendit.

Grafiku 9. Prirja e “Diarreve pa Gjak” në javët 06-07 të sezonit 2024-2025 dhe sezonit 2025-2026. Numri i rasteve.



Në javën 07 vërehet prirje në ulje e numrit të rasteve “Diarre pa gjak”, këtë vit vërehet një numër më i ulët i këtyre infeksioneve, krahasuar me një vit më parë.

Grafiku 10. Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas NJVKSH-ve në javën 06-07/2026 Incidenca (raste/10.000).



Vërehet një rritje e rasteve me diarre, veçanërisht në NJVKSH Tropojë, Berat, Kolonjë, ku situata po monitorohet në mënyrë të vazhdueshme.

Ngjarje ndërkombëtare

Fruthi –Monitorimi i shpërthimeve evropiane – monitorim mujor

- Në dhjetor 2025, 11 vende të BE/EEA raportuan 97 raste të fruthit. Shtatëmbëdhjetë vende raportuan zero raste.
- Gjatë periudhës së fundit 12-mujore, tetë vdekje që i atribuohen fruthit u raportuan në ECDC nga Franca (4), Rumania (3) dhe Holanda (1).
- Në përgjithësi, numri i rasteve u ul krahasuar me muajt e mëparshëm, gjë që është në përputhje me sezonalitetin e fruthit.
- Dy shpërthime janë zbuluar në Francë dhe Spanjë. Raste sporadike dhe grupe u raportuan në disa vende të BE/EEA. Përditësimet janë dhënë për disa vende jashtë BE/EEA.

Dengue –Monitorimi i shpërthimeve globale – Përditësim mujor

- Në janar 2026, mbi 100 000 raste të dengut dhe mbi 10 vdekje të lidhura me dengun u raportuan nga 39 vende/territore në nivel global sipas informacionit nga burime të disponueshme publikisht.
- Në vitin 2026, nuk është raportuar asnjë rast në BE/EEA duke përjashtuar rajonet më të largëta. Rastet janë raportuar nga Martinika, Guadelupa, Reunioni dhe nga Guiana Franceze (rajonet më të largëta franceze).

Gripi i shpendëve A(H9N2) –Monitorimi i rasteve te njerëzit

- Më 10 shkurt 2026, Hong Kongu raportoi dy raste të reja te njerëzit të infeksionit nga virusi i gripit të shpendëve A(H9N2) në Kinë, me fillimin e simptomave në dhjetor 2025 dhe janar 2026.
- Nuk u raportuan informacione të mëtejshme epidemiologjike për dy rastet.
- Në përgjithësi, 195 raste te njerëzit të gripit të shpendëve A(H9N2), përfshirë dy vdekje, janë raportuar që nga viti 1998 nga 10 vende.
- Rreziku për shëndetin e njeriut në BE/EEA aktualisht konsiderohet shumë i ulët.

Gripi i shpendëve A(H10N3) –Monitorimi i rasteve te njerëzit

- Një rast i ri te njerëzit i infeksionit nga virusi i gripit të shpendëve A(H10N3) u raportua në provincën Guangdong, Kinë.
- Rasti ishte një burrë 34-vjeçar, i cili kishte fillimin e simptomave më 29 dhjetor 2025.
- Nuk u dha asnjë informacion shtesë epidemiologjik.

- Nuk është dokumentuar asnjë transmetim nga njeriu tek njeriu.
- Rreziku për shëndetin e njeriut në BE/EEA konsiderohet shumë i ulët.

Sëmundja e virusit Chikungunya – Monitorimi i shpërthimeve globale – Përditësim mujor

- Që nga fillimi i vitit 2026, dhe që nga 31 janari (dita e fundit me të dhënat në dispozicion), afërsisht 2 882 raste të sëmundjes së virusit chikungunya (CHIKVD) dhe një vdekje e lidhur me CHIKVD janë raportuar në 11 vende/teritore.
- Rastet janë raportuar në Amerikë, Afrikë, Azi dhe Evropë (Francë – rajonet më të largëta, d.m.th. Reunion, Mayotte dhe Guiana Franceze).

Monitorimi i tubimeve masive – Lojërat Olimpikë dhe Paralimpikë Dimërore në Milano – 2026

- Që nga përditësimi i mëparshëm dhe që nga 12 shkurti, nuk janë zbuluar ngjarje të mëdha të shëndetit publik që lidhen me sëmundjet ngjitëse në kontekstin e Lojërave Olimpikë Dimërore.
- Probabiliteti që qytetarët e BE-së/EEA-së të infektohen me sëmundje ngjitëse gjatë Lojërave Olimpikë dhe Paralimpikë Dimërore 2026 është i ulët, nëse zbatohen masa të përgjithshme parandaluese.

Sëmundja e virusit Nipah – India dhe Bangladeshi – 2026

- Më 6 shkurt 2026, OBSH-ja publikoi një njoftim për vdekje të konfirmuar për shkak të infeksionit nga virusi Nipah (NiV) që ndodhi në Divizionin Rajshahi, në Bangladeshin veriperëndimor. Pacienti raportoi konsum të përsëritur të lëngut të papërpunuar të hurmës.
- Më 26 janar 2026, Pika Fokale Kombëtare e Rregullimit Ndërkombëtar të Shëndetit të Indisë raportoi te OBSH-ja se kishte pasur dy raste të konfirmuara të infeksionit NiV të raportuara në shtetin e Bengalit Perëndimor, Indi. Të dy rastet e konfirmuara janë te punonjësit e kujdesit shëndetësor në të njëjtin spital.
- Gjurmimi i kontakteve është kryer për të dyja ngjarjet dhe nuk janë identifikuar raste të tjera deri më tani.
- Tailanda, Nepali, Kamboxhia dhe vende të tjera fqinje kanë filluar masa, duke përfshirë fushatat informuese dhe shqyrtimin për pasagjerët që mbërrijnë nga India në aeroporte.
- Mundësia e ekspozimit dhe infeksionit me NiV për banorët e BE/EEA-së që udhëtojnë ose banojnë në Indi ose Bangladesh është aktualisht shumë e ulët, duke pasur parasysh numrin e ulët të infeksioneve në zonat ku janë identifikuar raste deri më sot.